



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MEMALIAJ
KËSHILLI BASHKIAK MEMALIAJ**

Nr. _____ prot.

Memaliaj më, _____ 2026

Relacion

**RAPORTI I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK MEMALIAJ PËR VITIN
2025**

Të nderuar!

Këshilli i Bashkisë Memaliaj la pas një vit sfidues për problematikat që ka hasur në komunikimin me ekzekutivin. Një aktivitet intensive dhe komunikim i vazhdueshëm rreth problematikave që janë shfaqur, duke u mbështetur te ligji 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, në legjislacionin sektorial për fusha të ndryshme të vetëqeverisjes vendore si dhe në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak”, në Rregulloren “Për konsultime publike” por jo vendimarrjes sa duhet për shkak të një ”konflikti artific” të krijuar midis kryetarit të bashkisë dhe organit vendimmarrës të këshillit bashkiak.

Duke qënë se Këshilli, si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit, ka rol vendimmarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, kemi ushtruar këto role me angazhim dhe përkushtim.

Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit, po paraqesim në mënyrë të përmbledhur aktivitetet kryesore të zhvilluara sipas kategorive.

Në lidhje me rolin vendimmarrës, janë kryer aktivitetet si më poshtë:

Referuar Planit të punës (përbërë nga plani i vendimmarrjes, plani i konsultimeve dhe buxheti i këshillit), miratuar me vendim nr.72 datë 28.10.2024 nuk janë realizuar 100% aktivitetet referuar planit të vendimmarrjes.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar në total 17 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 5 jashtë radhe (1 me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë dhe 4 të vendosura nga kryesia e këshillit

për mbarëvajtje të punëve në shërbim të komunitetit). Gjatë vitit 2025 është mbledhur Kryesia e Këshillit Bashkiak e cila ka vendosur mbi rendin e ditës në secilën mbledhje.

Në total janë miratuar 72 vendime prej të cilave 30 vendime të konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, janë shqyrtuar 42 akte individual, asnjë vendim të pakonfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Janë realizuar 30 mbledhje komisionesh.

Gjithashtu, kemi miratuar planin e punës të shoqëruar me planin e vendimmarrjes, konsultimeve dhe buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin me qëllim përmbushjen e të gjithë aktivitetit të parashikuar për vitin 2025, me vendim nr. 72 datë 28.10.2024

Për vitin 2025, Buxheti i Këshillit bashkiak është shpenzuar në masën 0%, shpenzime për shkak të mospranimit të realizimit të buxhetit të këshillit nga ana e administratës së bashkisë dhe kryetarit të bashkisë.

Këshilli i Bashkisë Memaliaj ka punuar dhe bashkëpunuar me projektin "Bashki të forta".

Një problematikë e vecantë ka qenë për publikimin e materialeve të ndryshme në web, si rendi i ditës, njoftimi për mbledhjet e këshillit, publikimi i të gjithë vendimeve online, si dhe procesverbaleve të mbledhjeve, duke mos ofruar mundësinë për t'i aksesuar në çdo kohë çdo qytetar për shkak të problematikës që ka pasur faqja e web-it të bashkisë. Këshilli bashkiak ka shqyrtuar të gjitha ankesat dhe kërkesat por zgjidhja e tyre nuk është bërë brenda afateve dhe proceduarve të parashikuara në Rregullore, për shkak të konfliktit artificel të krijuar nga kryetari i bashkisë në lidhje me tejkalimin e kompetencave të tija ligjore në lidhje institucionin e këshillit bashkiak duke bërë të pamundur për 4 muaj rresht pengimin e punës së Këshillit bashkiak.

Implementimi i rregulloreve, ka sjellë rritjen e standardeve dhe cilësisë së punës së këshillit në tërësi.

Këshilli bashkia ka shqyrtuar të gjithë projektvendimet dhe dokumentacionet shoqëruese në komisione, shoqëruar me raportet dhe procesverbalet sipas Rregullores. .

Njëkohësisht Bashkia Memaliaj, nuk kanë financuar asnjë trajnim për fuqizim të organit vendimmarrësë përmes rritjes së kapaciteteve të këshilltarëve vendorë për shkak të pamundësisë së përdorimit të buxhetit të këshillit. Trajnime që u nevojiten këshilltarëve për ushtrimin e detyrës së tij, si i zgjedhur nga komuniteti për t'i shërbyer atij.

Në lidhje me rolin përfaqësues të këshillit për vitin 2025 dhe referuar Planit të konsultimeve publike është synuar që komunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetit të realizohet nëpërmjet komunikimit kryesisht prej publikimit dhe marrjes së mendimeve nëpërmjet

rrjeteve sociale. Për këtë qëllim faqja e Facebook-ut e Këshillit Bashkiak Memaliaj e cila u hap në vitin 2020, ka qënë aktive duke publikuar vazhdimisht aktivitetet të këshillit, konsultimet publike, rendin e ditës etj.

Përsa u përket konsultimeve me publikun, në zbatim të Rregullores së Konsultimeve Publike kemi realizuar dëgjesa publike në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Memaliaj në lidhje me:

1. PBA-në.(vetëm faza e pare)

Nuk u zhvilluan konsultime për të gjitha kërkesat që përcakton ligji pasi administrata e Bashkisë nuk hartoi dhe dorëzoi në kohë projektbuxhetin afatmesëm 2025-2027, projektbuxhetin 2026 dhe paketën fiskale për vitin 2026 edhe pas kërkesave të vazhdueshme të Këshillit Bashkiak. Të gjetur në këto kushte këshillit bashkiak iu desh të tregohet fleksibël se mosmiratimi I këtyrve vendimeve most ë ndikonte në jetën e komunitetit të cilin përfapëson. Mbetemi të hapur për çdo sygjërim të komunitetit apo kërkesë për ta reflektuar në vendimmarrjet në vijim.

Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave /kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbëritura në drejtim të Këshillit të Bashkisë. Konkretisht janë depozituar ne total **36 kërkesa, 0 ankesë, 0 peticion,** drejtuar Këshillit Bashkiak, **29** prej tyre kërkesa për ndihmë financiare **27** prej të cilave është bërë e mundur marrja e vendimeve. Kërkesat e tjera janë trajtuar dhe janë koordinuar me ekzekutivin e bashkisë për t'u kthyer përgjigje brenda afateve dhe procedurave të caktuara.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përvec ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në **zbatim të planit të aktiviteve të vitit 2025 u realizuan 14 kërkesa për informacion nga ku u paraqitën në këshill 3 informacione, dhe 1 raport nga administrata parashikuar në planin e punës së këshillit.**

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar secilin për kontributin dhe angazhimin duke ju ftuar të gjithëve të bëheni pjesë për përmirësimin e punës së këshillit nëpërmjet mendimeve dhe sugjerimeve tuaja.

Punë të mbarë dhe faleminderit.

**SEKRETAR I KËSHILLIT
ERJOLA ALLKA**